



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHEM EKONOMIK

## Njoftim Publik

Bashkia Shkodër shpall thirrjen e hapur ‘Skemë granti për bizneset inovative’, e financuar nga burime publike, për dorëzimin e aplikimeve për grante.

### 1. Qëllimi i Thirrjes

Qëllimi i kësaj thirrje është të mbështesë plane të qëndrueshme biznesi të krijuara nga sipërmarrësit aspirantë dhe zhvillimin e bizneseve ekzistuese, të cilat synojnë të shndërrohen në biznese inovative përmes zbatimit të ideve, produkteve, shërbimeve apo proceseve inovative, të cilat rrisin konkurrueshmërisë dhe qëndrueshmërisë në treg.

Skema do të zbatohet në të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër.

### 2. Mbështetja e Skemës

Skema e granteve synon të mbështesë sipërmarrësit aspirantë në zhvillimin e ideve të biznesit të suksesshme dhe testimin e tyre për të tejkaluar vështirësitë e ndryshme të tregut. Për këtë qëllim, Bashkia Shkodër do të organizojë takime informuese (“ditë të hapura”) me të gjithë individët e interesuar ku do të informohen në detaje rreth thirrjes së shpallur, mënyrës së aplikimit, kriteret, etj.

### 3. Aplikantët e Pranueshëm

Aplikantët e pranueshëm për këtë Thirrje **janë shtetas shqiptarë mbi moshën 18 vjeç, banues në Bashkinë Shkodër, të cilët kanë një ide biznesi ose kanë një biznes ekzistues dhe synojnë ta shndërrojnë atë në një biznes inovativ.**

Thirrja është e hapur për këto kategori:

**Sipërmarrësit Aspirantë:** Individë që kanë ide për të filluar një biznes të ri dhe kërkojnë mbështetje për të realizuar këto ide.

**Bizneset ekzistuese:** Biznese ekzistuese me qarkullim vjetor  $\leq 8,000,000$  lekë/vit që kërkojnë të zgjerohen, të modernizohen ose të implementojnë praktika të qëndrueshme dhe inovative.

Aplikantët mund të marrin pjesë në thirrje vetëm me 1 (një) ide biznesi.

#### 4. Aktivitete biznesi të pranueshme

Aktivitetet e pranueshme për biznes janë nga sektorët e mëposhtëm, përkatësisht:

- IT;
- Inteligjencë artificiale;
- Turizëm/ Agroturizëm;
- Mjedis;
- Energji e rinovueshme;
- Shërbime/Prodhim;
- Artizanat;
- Marketing;
- Teknologjia e informacionit dhe zhvillimit.

#### 5. Mbështetje financiare

Efektet financiare do të përballohen nga buxheti i miratuar çdo vit për Bashkinë Shkodër për thirrjen “Skemë granti për bizneset inovative”.

Aplikantët e përzgjedhur duhet të bashkëfinancojnë **20%** të shumës së grantit por mund të planifikojnë edhe financime të tjera shtesë duke përdorur instrumente financiare (kredi, dhënie me qira, grante, etj.) të disponueshme në Shqipëri përmes institucioneve financiare ose projekteve të financuara nga donatorë, ose financat e veta. Ky burim financimi duhet të përfshihet në planin e biznesit dhe do të jetë subjekt i vlerësimit.

#### 6. Si të Aplikoni

Të gjithë Formularët e plotësuar të Aplikimit do të dorëzohen në Sektorin e Z1N në Bashki **në tre kopje origjinale dhe nje kopje elektronike në CD/USB**. Aplikantët janë të detyruar që të dorëzojnë të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas fazave të përcaktuara në Udhëziesin e aplikimit.

**Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit në Fazën e I është data 22/05/2026 ora 16:00.**

#### **Dokumentacioni i cili duhet dorëzuar për aplikim në Fazën e I-rë është:**

Faza e 1: Dorëzimi i aplikimit të ideve të biznesit;

1. Formulari i aplikimit për ide biznesisipas modelit të kërkuar;
2. Kopja e kartës së identitetit të Aplikantit;
3. Dokumenti i regjistrimit në organin tatimor (NIPT), për bizneset ekzistuese;

4. Vërtetim xhiro për 3 vitet e kaluara nga e-albania për bizneset ekzistuese;
5. Vërtetim për saktësim adrese.

**Vetëm aplikimet të cilët kanë kaluar fazën e I-rë, duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm për fazën e II-të:**

1. Plani i Biznesit dhe Financimit sipas modelit të kërkuar;
2. Dorëzimi i pasqyrave financiare (bilanci) për dy vitet e fundit të aktivitetit të biznesit;
3. Çertifikime/patenta, apo dokumente të tjerë suportues të cilët vërtetojnë elementin inovativ përbëjnë prioritet; (Nëse kanë);
4. Vërtetim nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nëse aplikanti nuk ka detyrime financiare ndaj këtij institucioni; (për aplikantët të cilët kanë biznes ekzistues);
5. Dëshmi penaliteti e aplikuesit, lëshuar gjatë muajit të hapjes së thirrjes;

**Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit në Fazën e II është data 26/06/2026 ora 16:00.**

Të gjithë aplikantët duhet t'i qëndrojnë në mënyrë rigoroz formatit të aplikimit dhe formateve të bashkëngjitura në këtë udhëzim.

**Çdo aplikim që merret pas datës së shpallur të mbylljes do të quhet i pavlefshëm.**

**Çdo aplikant mund të aplikojë me vetëm një ide për biznes**

**Informacione të tjera**

Paketa e plotë e aplikimit dhe informacione shtesë mund të gjenden në adresën [www.bashkiashkoder.gov.al](http://www.bashkiashkoder.gov.al)

Për më shumë informacion, ju lutem kontaktoni në **Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit** nëpërmjet adresës së e-mail: [planifikimistrategjik@bashkiashkoder.gov.al](mailto:planifikimistrategjik@bashkiashkoder.gov.al)

**Dita e hapur do të organizohet me datë 4 maj, ora 11:00 pranë ambjenteve të Bashkisë Shkodër.**

Për shkarkimin e dokumentacionit të nevojshëm, ju lutem klikoni si më poshtë:

- Aneksi 1 – Thirrje e Hapur
- Aneksi 2 – Njoftimi i Takimeve Informuese
- Aneksi 3 – Formulari i Aplikimit - Faza I
- Aneksi 4 – Tabela e Vlerësimit
- Aneksi 5 – Formulari për Plan Biznesi - Faza II
- Aneksi 6 – Plani Financiar- Faza II
- Aneksi 7 – Deklarata e Plotësimit të Kriteve

Aneksi 8 – Udhëzues i Aplikimit  
Aneksi 9 - Deklarata e Plotësimit të Kriteve